# TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

# VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË FIER

# 2024

PËRGATITUR NGA:

QENDRA "EPOKA E RE"

RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

# Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

*Bashkia Fier*

Përgatiti: Qendra "Epoka e Re"

Korrik 2024

## Tabela e Përmbajtjes

# LISTA E


TABELA E PËRMBAJTJES ........ 2
SHKURTIME ........ 3

**HYRJE** ........ **4**

**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** ........ **7**

METODOLOGJIA ........ 9

**KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR** ........ **11**

PËRSHKRIMI I STRUKTURES SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË FIER ........ 15

***KËSHILLI I BASHKISË FIER*** ........ **17**

**HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË FIER** ........ **18**

**VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK** **20**

NJOHURI MBI LIGJIN PËR KONSULTIMIN PUBLIK ........ 21
NJOFTIMI PËR DËGJESAT PUBLIKE ........ 23
BESIMI NË PËRMIRËSIMIN E VENDIMMARRJES PËRMES PROCEDURAVE TË KONSULTIMIT PUBLIK ........ 24
INFORMACIONI I MARRË NGA BASHKIA FIER NË LIDHJE ME NJOFTIMIN, ORGANIZIMIN, PASQYRIMIN, INFORMIMIN PUBLIK MBI PROCESET E KONSULTIMIT PUBLIK ........ 25
HULUMTIMI MBI TRANSPARENCËN E PROCESIT QË NGA NJOFTIMI, INFORMIMI, E PUBLIKIMI. ........ 31
PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK ........ 33
REKOMANDIMET ........ 34
REFERENCA ........ 37
ANEKS- 1 / KËRKESA PËR INFORMACION DËRGUAR BASHKISË FIER ........ 38
ANEKS-2/ PËRGJIGJJA E BASHKISË FIER ........ 41
ANEKS-3/ PYETËSORI ONLINE ........ 44

## Shkurtime

| | |
|---|---|
| *BF* | *Bashkia Fier* |
| *QV* | *Qeverisje Vendore* |
| *NJA* | *Njësi Administrative* |
| *KBF* | *Këshilli Bashkiak Fier* |
| *VKB* | *Vendimi Këshillit Bashkiak* |
| *VKM* | *Vendim i Këshillit të Ministratave* |
| *URB* | *Zonat Urbane* |
| *RUR* | *Zonat Rurale* |
| *PAK* | *Personat me aftësi të kufizuar* |
| *PBA* | *Buxheti Afat-Mesëm* |
| *OSHC* | *Organizata e Shoqërisë Civile* |
| *KVR* | *Këshilli Vendor Rinor* |
| *GSM* | *Grupi i Menaxhimit Strategjik* |
| *KDIMDP* | *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale* |
| *POP* | *Përballja e Ofertave Politike* |

# Hyrje

Qeverisjet (qendrore dhe vendore) janë mekanizma koordinues dhe drejtues të shoqërive për një bashkëjetesë mbi disa parime të shprehura nëpërmjet ligjeve, të detyrueshme për tu zbatuar nga të dy palët, të cilat mbartin të drejta dhe detyrime të ndërsjellta. Misioni i njësive të qeverisjes vendore është të sigurojë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b)respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja publike janë parimet kryesore kur kemi të bëjmë me ruajtjen dhe avancimin e demokracisë. Krijimi dhe forcimi i urës së komunikimit, dialogut ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur vendor, duke përfshirë gjithashtu edhe përfshirjen e tyre (qytetarëve) në proceset vendimmarrëse dhe politikbërjes lokale është thelbësore për demokracinë, sepse ajo forcon legjitimitetin e institucioneve demokratike vendore dhe efektivitetin e veprimeve të tyre.

Një nga shtyllat kryesore të një qeverie të mirë dhe deduktor i performancës së saj është procesi i konsultimit publik. Niveli i suksesit të këtij procesi pasqyron nivelin e cilësisë së punës dhe përmbushjes së misionit të qeverisjes vendore. Ky proces u mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit njohjen me politikat lokale, ecurinë e punës së bashkisë, përgjegjësitë dhe zhvillimet administrative, investimet prioritare, prioritetët institucionale, vizionin e qeverisjes vendore. Nëpërmjet diskutimit dhe dialogimit parashtrohen kërkesat dhe interest e komunitetit që parimisht duhet merren në konsideratë nga qeverisja vendore dhe në bazë të rëndësisë së problematikave dhe masivitetit të përfshirjes komunitare parashikohen në projektaktet vendore. Këto procese kanë rëndësi edhe për faktin se bëhet një ballafaqim mes qeverisjes dhe komunitetit mbi mënyrën e  punës dhe trajtimit të interesave qytetare në formën e llogaridhënies, duke krijuar një mundësi vlerësimi të performacës institucionale dhe punës së përfaqësuesve të qeverisjes vendore.

Për këtë arsye angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesor drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes

organizmave të shoqërisë civile. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, mbështetjen nga qytetarët në vendimmarrje, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, rritjen e besueshmërisë, transparencës dhe krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë të drejta ekskluzive të saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijojnë të kërkojnë, adaptojnë dhe zbatojnë modele ku qytetarët, grupet e interest dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i situatës ekzistuese në lidhje me praktikat e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike"[1] në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike", financuar nga National Endoëment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Përmes këtij program, Rrjeti POP synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë.

Organizatat anëtare të Rrjetit POP veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, të mbuluara nga mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë, në periudhën prill – qershor 2024 është realizuar studimi "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik". Studimi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara për periudhën shtator 2023 – maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të ligjit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij.

[1]Faqe zyrtare RRrjeti POP https://popnetwork.al/

Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit ku përmendim, institucionin e Prefektit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endoëment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

# Përmbledhje Ekzekutive

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike”, financuar nga National Endoëment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij program synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë.

Në Bashkinë Fier studimi është përgatitur nga Qendra “Epoka e Re”, organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeverinë vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësianë Nivel Vendor –Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Fier” vlerësoi situatën e realizimit të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjesave publike, duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel vendor.

Në periudhën prill – qershor 2024, janë intervistuar 11 (7F/4M) zyrtarë vendorë, përfaqësues të Bashkisë Fier dhe Këshillit Bashkiak, ndërsa janë intervistuar ballë përballë 27 (14F/13M) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga grupet e interesit që kanë qenë pjesë e dëgjesave publike. Gjithashtu është shpërndarë edhe një pyetësor online, i cili është klikuar nga 106 qytetarë të bashkisë Fier, (65F/36M/5pa përgjigje), por vetëm 101 prej tyre e kanë plotësuar atë deri në fund, duke dhënë vlerësimin mbi njohjen e perceptimin e tyre mbi njoftimin e konsultimin publik.

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak (KB) Fier, duhet të demonstrojnë përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre me efikasitet, efektivitet dhe transparencë, në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Ndërkohë, komuniteti dhe veçanërisht shoqëria civile, nga ana e tyre, duhet të përfitojnë dhe përdorin me mençuri këto mekanizma, duke ushtruar rolin e tyre të domosdoshëm dhe fuqinë që ligji iu jep në sigurimin e një qeverisjeje të drejtë, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit.

Mobilizimi dhe angazhimi aktiv i qytetarëve në nivel vendor, debate të hapura, ndarja dhe shkëmbimi i përvojave, apo ideve të ndryshme, shqyrtimi i të gjitha alternativave të mundshme, duhet të jenë reale dhe jo një formalitet sa për procedurë. Angazhimi dhe përfshirja qytetare është një nevojë e domosdoshme që është rregulluar me ligj për t'u zbatuar në të gjitha fazat ashtu sic është parashikuar, për të mundësuar një vendimmarrje të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse për çdo bashki.

Njohja dhe zbatimi efektiv i ligjit, synon të sigurojë transparencën e munguar prej vitesh, ndaj vendimarrjes së KB-së dhe të bashkisë, të cilët zakonisht i konsiderojnë dhe konsultimet publike, si procese që duhen bërë sa për të qenë në rregull me ligjin, e në më të shumtën e rasteve i anashkalojnë pothuajse të gjitha fazat e dispozitave normative, duke lënë mënjanë dhe përjashtuar qytetarët, palët e tjera të interesuara (OSHC-të) dhe duke zvogëluar ndjeshëm hapësirat e pjesëmarrjes. Për pasojë, vendimet që zbatohen bëhen më të vështira për t'u pranuar nga të gjithë aktorët dhe komuniteti.

Gjetjet e studimit tregojnë se qytetarët nuk kanë besim të bëhen pjesë e proceseve konsultuese si dhe në ato raste kur raportojnë që kanë qenë pjesë e tyre, ata pohojnë se nuk besojnë se zëri i dëgjohet dhe kjo e reflektuar nga eksperiencat e kaluara.

Midis krahasimit të kuadrit ligjor, formave të zbatuara dhe vlerësimeve të marra në kuadër të studimit të realizuar, vëmë re se ligji njihet dhe zbatohet në mënyrë modeste si nga ekzekutivi, edhe nga vendimmarrësit.

Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale vazhdojnë të jenë sfida për autoritetet vendore, duke shërbyer në të njëjtën kohë dhe si tregues të funksionimit të demokracisë lokale.

Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, duke përcaktuar qartë se cilat projekt-akte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik në nivel vendor, duhet të qartësojë nevojën për ndryshime ligjore dhe praktika shtrënguese për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Gjithësesi, grupet e interesit, OSHC-të lokale dhe qytetarët aktiv në komunitet duhet të rrisin kapacitetet duke:a) njohur të drejtat e tyre për të ushtruar presion pozitiv dhe për t'u ankuar pranë

institucioneve përgjegjëse b) duke u përballur edhe në gjykatë për çështje me inters të lartë publik.

## Metodologjia

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014[2]) në bashkinë Fier, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjetesh dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor "Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik" realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.[3]
- Rishikimin e dokumentave strategjikë, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.
- Kërkesa zyrtare për informacion, drejtuar institucionit të bashkisë dhe kryetarit të saj.

- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit; trajnimin e intervistuesve; 11intervista të drejtpërdrejta dhe të thelluara me stafin e bashkisë dhe Këshillin bashkiak: (Nën kryetare të bashkisë; Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik & për të Drejtën e Informimit dhe Transparencën; Drejtoria e Financës, zëdhënëse e shtypit, Kryetaren e Këshillit Bashkiak, nënkryetarin, sekretarin, anëtarë të Komisionit të Ekonomisë, Financës dhe Privatizimeve, Komisionit Juridik dhe i çështjeve Institucionale, Komisionit për Mbikqyrjen, Kontrollin dhe Nënshkrimin e Proces – Verbaleve të Mbledhjes. 27 intervista të thelluara me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga grupet e interesit që kanë qenë pjesë e dëgjesave publike, 106 pyetësorë online si edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjikë, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë:

- ✓ Faqet zyrtare të internetit të bashkisë dhe Këshillit të Bashkisë
- ✓ Rregullorja e brendshme e bashkisë
- ✓ Publikimi i njoftimeve, dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara

---

[2]Ligji per NJoftimin dhe Konsultimin Publik: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e

[3]Raporti Studimor përgatitur nga Epoka e Re: https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-fier/

- ✓ Raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare, apo organizata të shoqërisë civile, etj.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, janë hulumtuar dokumentat e prodhuara nga tre institucionet që monitorojnë drejtëpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimit Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar stafeve bashkiakë të NjVQV, pyetësorë dhe intervista të thelluara me koordinatorët e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, sekretarët e këshillave bashkiakë stafet e bashkive dhe aktivistë qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në rregjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proceset pjesëmarrëse.

Pyetësorët përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore, duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat, informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Paralelisht u trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokalë, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat synonin sigurimin e marrjes së informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe u analizuar. Qendra "Epoka e Re" përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të advokuar me përfaqësues të qeverisjes vendore, nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Ky raport është rezultat i punës intensive në zyrë dhe kontributit në terren nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërsië civile, anëtare të rrjetit POP.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet,

konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare[4] dhe sekondare[5] për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndërmarrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

## Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisë një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen vendore, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, nëpërmjet forcimit të legjitimitetit dhe efektivitetit të veprimeve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së qeverisjes vendore.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Fier i Ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" dhe Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të cilat e detyrojnë qeverisjen vendore të garantojë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimmarrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, janë:

- Ligji Nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"
- Ligji Nr.119/2014 "Përtë Drejtën e Informimit"
- Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"
- Ligji Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Ligji Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

[4] Burime prioritare: ligjinr.146/2014, "PërNjoftimindheKonsultiminPublik", informacioni në lidhje me procesin e konsultimi publik, publikuar në faqe zyrtare të bashkisw Fier dhe informacioni I përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim

[5] Burime sekondare: raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit nëçdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues, kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive[6] të tyre në procesin e vendimmarrjes. Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”[7] në nenin 5 të tij, përcakton parimet si më poshtë, në lidhje me njoftimin dhe konsultimin publik:

a) Transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
b) Efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
c) Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

### Çfarë rregullon ligji për njoftimin dhe konsultimin publik?

- ✓ *Ligji rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që i përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.*

- ✓ *Ligji synon transparencën e organeve publike, duke mundësuar dhe nxitur gjithëpërfshirjen e publikut dhe palëve të tjera të interesuara pa asnjë dallim, në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes të lartë publikë.*

### Cilat janë të drejtat e personave ose palëve të interesuara për konsultimin publik?

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, grupet e interesit, personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Shqipëri, si dhe personat juridikë të huaj të regjistruar në vendin tonë gëzojnë këto të drejta në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik:

a) Të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik si dhe të njihen me përmbajtjen e projektaktit.

b) T’i kërkojnë organeve publike që të fillojnë procedurën për hartimin dhe miratimin e projektaktit, nëse ky është publikuar në planin vjetor të procesit vendimmarrës të organeve publike;

c) Të shfaqin mendime dhe sugjerime për projektaktin, të cilat duhet t’i bëhen me dije organit publik;

[6]Neni 16 dhe neni 18 I ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

[7] https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e

## Si mund të marrim dijeni për procesin e konsultimit publik?

- Njoftimin për projektaktin për të cilin ne kemi interes duhet ta marrim pa filluar ende hartimi i tyre.
- Çdo organ publik ka detyrimin që në programet e transparencës, të cilat vijnë si një detyrim i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të publikojnë gjithashtu planet vjetore që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Këto plane duhet të publikohen para se të fillojë procesi i hartimit të projektakteve dhe aty duhet të pasqyrohen nismat
- Pasi projektakti hartohet nga organi publik por ende nuk është miratuar prej tij, ky i fundit ka detyrimin t'i publikojnë projektaktet në një regjistër elektronik, i cili mund të aksesohet/shikohet nga të gjitha palët e interesuara që do të ndërmerren në vitin pasardhës.
- Ligji parashikon edhe mënyra të tjera për të informuar/njoftuar palët e interesuara për konsultimin publik, përkatësisht me anë të:
    - ✓ Postës elektronike (e-mailit);
    - ✓ Lajmërimit publik, i cili afishohet në ambientet e institucionit që e publikon;
    - ✓ Lajmërimit në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
    - ✓ Botimit në gazetat lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.

## Para se të fillojë konsultimi publik, cili është informacioni që duhet të disponojmë?

- Personat ose palët që kanë interes për t'u konsultuar për projektaktin, pajisen me informacionin e nevojshëm për t'u krijuar atyre mundësinë të kontribuojnë në mënyrën më efektive të mundshme gjatë procesit të konsultimit publik. Para se të fillojë konsultimi publik, organi publik nismëtar duhet të informojë palët e interesuara minimalisht për:
- Arsyet përse po ndërmerret nisma dhe ndikimin që ajo do të ketë;
- Afatin, vendin dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara mund të dërgojnë mendimet ose rekomandimet e tyre;
- Kontaktet e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, i cili është përgjegjës për mbledhjen e rekomandimeve;
- Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik, kur organi publik vendos ta zhvillojë konsultimin në këtë formë.

## Duhen patur parasysh dhe marrë në konsideratë disa elementë:

- Konsultimi në vend dhe kohë kur propozimet jane ende në fazë formuese;
- Argumentimi mjaftueshëm i propozimeve për t'i lejuar konsulentët t'i kuptojnë ato dhe t'u përgjigjet siç duhet ;
- Dhënia e një kohe të mjaftueshme për të bërë pyetje dhe shqyrtuar përgjigjet;
- Marrja seriozisht dhe me ndërgjegje e përgjigjeve;
- Respektimi i standardeve minimale të konsultimit;
- Vlerësimi i ndikimit në komunitet / barazia gjinore;
- Mbajtja e regjistrit të konsultimeve.

**Standardet cilësore të konsultimit publik** [8]
Me qëllim që të realizohet një proces konsultimi publik cilësor, është shumë e rëndësishme që të përcaktohet një set standardesh cilësore që duhen patur në konsideratë në çdo rast të angazhimit qytetar.

***Standardi i përfshirjes së komunitetit***
Në konsultimin publik grupet qytetare dhe organizatat me interes dhe me fokus në fushën për të cilën realizohet konsultimi public duhet të përfshihen drejtëpërdrejtë. Angazhimi i tyre është jetik për procesin.

***Standardi i të punuarit së bashku***
Duhet të ketë procedura të qarta që i lejojnë pjesëmarrësit në konsultim të shprehin mendimet dhe propozimet e tyre, por gjithashtu të dëgjojnë dhe respektojnë mendimet dhe propozimet e pjesëmarrësve të tjerë. Duhen përcaktuar rregulla të qarta të të punuarit së bashku, nëse doni që angazhimi publik të jetë efiçent dhe efektiv.

***Standardi i komunikimit dhe shkëmbimit reciprok të informacionit***
Diskutimi publik është një proces që do të vazhdojë edhe pas takimit, ose ndërmjet dy takimeve, por duhet të sigurohet që komunikimi vijon dhe pjesëmarrësit janë të informuar për gjithcka që diskutohet në grup.

**Procedura që realizohen me konsultim publik:**

- Konsultimet me publikun për Buxhetin sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë (draft/projektbuxhet) deri te version final të programit buxhetor afatmesëm. Shtrirja kohore e realizimit të këtij procesi është 30 qershor – 30 shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GSM) realizojnë dëgjesa publike nga 1 shtatori – 30 nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.
- Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.
- Ndryshim destinacioni i pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimarrja i takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.
- Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga adminsitrata e bashkisë ose nga vetë këshilli bashkiak, para miratimit duhet t’i nënshtrohen procedures së konsultimit publik.
- Vendimarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare si: rrugë publike, parqe e lulishte, landfill, inevstime etj, ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve.

[8] Manual udhëzues për njësitë e vetëqeverisjes vendore https://info.undp.org/docs/pdc/Documents/ALB/Manual%20udhezues%20per%20konsultimin%20publik_Final%20%20(1).pdf

## Përshkrimi i struktures së qeverisjes lokale në bashkinë Fier

***Profili i bashkisë Fier***

Bashkia Fier ka një sipërfaqe prej 619.90 km2 dhe përbëhet nga 13 njësi administrative. Karakterizohet nga një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metra mbi nivelin e detit dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.

Fieri shtrihet në pjesën qendrore - perëndimore të Shqipërisë, në jug të fushës së Myzeqesë dhe ndodhet 18 km larg bregut të detit Adriatik. Kjo bashki përbëhet nga dhjetë njësi administrative, të cilat janë: Fier, Cakran, Mbrostar Ura, Libofshë, Qendër, Dërmenas, Topojë, Levan, Frrakull dhe Portëz. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra.

Bashkia e Fierit[9] gëzon një pozitë gjeografike dhe strategjike të favorshme. Në të kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit: korridori VIII dhe korridori i kaltër (autostrada Adriatiko-Joniane). Ajo përfshin disa nga zonat bujqësore më të rëndësishme të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës. Kufizohet nga dy lumenj kryesor, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron parkun arkeologjik kombëtar të Apolonisë; si dhe trashëgon zona industriale dhe naftëmbajtëse si dhe gëzon pozicionim strategjik avantazhues përsa i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj.

Në territorin e bashkisë gjenden toka shumë pjellore. Bashkia Fier (pas ndarjes territoriale 2015) ka një vijë bregdetare të konsiderueshme rreth 27km, nga grykëderdhja e lumit Vjosë deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.

Shfrytëzimi i bregdetit për turizëm është ende në fillesat e veta. Njësitë administrative Topojë dhe Dërmenas kanë një vijë bregdetare ranore prej 30 kilometrash, e gjitha shumë e përshtatshme për turizmin familjar. Vlerësohet se rreth 10 mijë vetë në vit zgjedhin këtë vijë bregdetare për pushime verore, kryesisht afatshkurtra.

### *Popullsia*

Bashkia e Fierit, në bazë të statistikave të vitit 2011 (sipas Censusit) regjistronte 196,324 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile në vitin 2016 regjistron 200,376 banorë (burimi Ministria e Brendshme). Dendësia e popullsisë llogaritet në rreth 316.7 banorë/km2. Më shumë se 55 % e popullsisë së bashkisë jeton në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike. Prodhimi bujqësor është i shumëllojshëm nga drithi te zarzavatet,

[9] https://planifikimi.gov.al/index.php?id=761

POP PERBALLJA OFERTAVE POLITIKE

OLOF PALMES INTERNATIONELLA CENTER | Suedi Sverige | NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

bostanoret, blegtoria dhe nënproduktet e saj. Raporti gjinor në Bashkine e Fierit, sipas Census të 2011, është 101.2, duke u paraqitur pak më lartë se mesataraja 100.4 në gjithë Shqipërinë.

Më shumë se 55 % e popullsisë së bashkisë jetojnë në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike. Prodhimi bujqësor i kësaj zone është i shumëllojshëm nga drithi te zarzavatet, bostanoret, blegtoria dhe nënproduktet e saj.

***Zhvillimi i Bashkisë Fier*** udhëhiqet nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ka në fokus mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj, mbështetur në një mjedis të shëndetshëm dhe me aftësi vetë-ripërtëritëse. Koncepti i zhvillimit të Fierit shkon përtej atij ekonomik, duke synuar gjithmonë e më tepër që ky i fundit të harmonizohet me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e kontrasteve sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual.

Një nga objektivat kryesor të Bashkisë Fier është konsolidimi i profilit të saj si pol i zhvillimit ekonomik rajonal, përmes diversifikimit të ekonomisë dhe krijimit të kushteve për rritjen e konkurrueshmërisë në nivel vendi dhe më gjerë. Misioni i Bashkisë në funksion të realizimit të vizionit strategjik të zhvillimit është vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bashkia ka hartuar projekt buxhetin afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2024 – 2027. Bashkia ofron një buxhet realist dhe të ekuilibruar. Administrimi i Bashkisë, shërbime publike vendore, arsimi bazë dhe parashkollor, menaxhimi i mbetjeve dhe trashëgimia kulturore zënë peshën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë për tre vitet e ardhshme.

Hartimi i projektbuxheteve kalon perms proceseve konsultuese me qytetarët. Si rezultat i kësaj, projekt buxhetet tentojnë t'i përgjigjen nevojave të komunitetit, duke qenë se në to reflektohen një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të mbledhura ng aprocesi i konsultimit.

Transparenca mbetet ende një sfidë për Bashkinë Fier. Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", dhe ligjit119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", nëmbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, transparenca, përfshirë informimin publik janë shërbime që do t'u ofrohen qytetarëve edhe nëpërmjet fuqizimit të sistemit elektronik, siç janë rrjetet sociale dhe faqja zyrtare ëeb e Bashkisë.

Për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në bashkinë Fier shërbejnë sportelet e Zyrës me Një Ndalesë, një shërbim që funksionon për më shumë se10 vite dhe që ka garantuar cilësi shërbimi në një kohë më të shkurtër e produktive.

***Këshilli i Bashkisë Fier***

Këshilli i Bashkisë Fier, (KBF) përbëhet nga 51 anëtarë (23F/28M)[10]. Mbështetur në pikën a) të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, është miratuar me VKB nr.27 datë 15.04.2020 Rregullorja e Këshillit Bashkiak dhe Rregullorja për Konsultimet Publike. Rregullorja e KB, ka ndryshuar në nëne të caktuara të saj me VKB nr. 88 datë 24.07.2023.

***Me vendim Nr.11, datë 27.01.2017[11], është miratuar rregullorja e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Fier.***

Në KBF ushtrojnë funksionin 7 Komisionet e përhershme[12]:

1. Komisioni Juridik dhe i Çështjeve Institucionale
2. Komisioni i Ekonomisë dhe Financës
3. Komisioni i Çështjeve Sociale
4. Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sportit dhe i Marrëdhënieve me Jashtë
5. Komisioni për punët Publike dhe Emergjencat.
6. Komisioni i Mandateve
7. Komisioni i Votimi

***Përgjatë periudhës shtator 2023 –Maj 2024, në regjistrin e kërkesave dhe ankesave të KB Fier janë depozituiar vetëm 3 kërkesa[13]:***

- Kërkesë për rritje tarife të ujit nga Ujësjellësi Fier
- Kërkesë për Ndihme Ekonomike dhe mbeshtetje financiare
- Kërkesë për Emërtim Rruge

**Në faqen zyrtare të KBF-së , është pasqyruar i gjithë aktiviteti i vendimmarrësit lokal, i ndarë në sesione informuese:**

- ✓ Regjistri i projekt akteve për konsultim publik[14], të Këshillit Bashkiak
- ✓ Regjistri i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave qytetare[15]
- ✓ Regjistri publik për transparencën e Mledhjeve të Këshillit Bashkiak[16]

---

[10] https://bashkiafier.gov.al/anetaret/
[11] https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Rregullore-e-Keshillit-Bashkiak.pdf
[12] https://bashkiafier.gov.al/komisionet/
[13] https://bashkiafier.gov.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-ankesave/
[14] https://docs.google.com/spreadsheets/d/1nI0tGv-2YPMMmyd8-6dTs58EO9aSQ39wpFOlcggwkVk/edit?gid=0#gid=0
[15] https://docs.google.com/spreadsheets/d/1Jer6LkjstUq9VYCMEMcmehNafyGOzu-qxUbQf2kTSkI/edit?gid=0#gid=0

## Historiku i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Fier

Për një qeverisje të mirë vendore, prezenca e komunitetit në procese dhe aktivitete deçisive institucionale është primare, pasi mendimi dhe interezsat e tyre qëndrojnë në krye të misionit qeverisës. Që kjo prezencë të jetë në nivelin e  duhur dhe të japë efekt në vendimmarrje duhet që të rritet besimi I komunitetit, pengesë e nxjerrë në cdo raport të kaluar studimor, por edhe në atë pararendës të zhvilluar nga POP për njoftimin dhe konsultimin publik. Një nga elementët që ndikon drejtëpërdrejtë në uljen apo forcimin e besimit qytetar është “Transparenca institucionale”. Transparenca lufton korrupsionin, rrit besimin e qytetarëve dhe në qeverisje është element kyç në mbarëvajtjen e proceseve në nivel lokal dhe kombëtar. Ajo konsiderohet si baza e qeverisjes së mirë dhe komuniteteve të fuqishme që dine çfarë kanë, çfarë duan dhe si të veprojnë.

Të tillë duket se e ka konsideruar edhe Bashkia Fier, pasi kemi disa zhvillime positive në këtë aspekt. Mungesa e aksesit në faqen zyrtare të bashkisë për një periudhë relativisht të gjatë (për shkak të formatit jo të përshtatshëm dhe problemeve të shumta teknike), e ka penalizuar edhe në raportin pararendës mbi këtë fokus këtë bashki. Sot ky ngërc duket se është tejkaluar[17] edhe pse disa problematika vazhdojnë të mbeten prezent.




Faqja zyrtare (Web) e Bashkisë Fier




Përsa i përket praktikave të kahershme të infomimit të tilla si: publikimet fizike dhe infomimi i drejtëpërdrejtë në rrjetet sociale apo media audiovizive, Bashkia përdor të gjitha mënyrat për të shpërndarë njoftimet me interes publik si online ashtu edhe shpallje në vende me akses të gjerë.

Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë https://bashkiafier.gov.al/

[16] https://docs.google.com/spreadsheets/d/1RPpB-bJFp95TlTJeA4f6H7kSTglnFBPAbo5mck6aoHc/edit?gid=0#gid=0

[17] WEB i ri i bashkisë Fier https://bashkiafier.gov.al/

- Për të njëjtin qëllim shërben edhe faqja zyrtare e Facebook e Bashkisë https://www.facebook.com/bashkia.efierit/ , si dhe faqja zyrtare e Facebook e Këshillit Bashkiak https://www.facebook.com/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Fier-104337948185698

- Kërkesat e qytetarëve, në masë vazhdojnë të bëhen në mënyrën klasike (me shkresë nëpërmjet Koordinatorit të Informimit) në sportelet e Zyrës me Një Ndalesë. Një pjesë e tyre nëpërmjet postës elektronike info@bashkiafier.gov.al dhe një pjesë e vogël, kryesisht ato me karakter institucional, nëpërmjet postës shqiptare.

- Ankesat masivisht adresohen nëpërmjet postës elektronike (inbox) të FB të bashkisë https://www.facebook.com/bashkia.efierit/ , ose në e-mail, por dhe pse në përqindje të vogël vazhdojnë ankesat me shkrim drejtuar Kryetarit të Bashkisë.

- Disa vite më parë u vendosën kuti për mbledhjen e ankesave të qytetarëve në çdo godinë të Njësive Administrative, por nuk dhanë rezultat dhe sot kanë dalë jshtë funksionit.

- Një vit më parë u hap një dritare e re si mundësi e shtuar për informimin dhe njoftimin e publikut, e cila vazhdon të jetë funksionale, një llogari e Këshillit Bashkiak Fier në rrjetin social FB. Kërkesat, ankesat, apo aplikimet e drejtëpërdrejta kanë një rezultat më të mirë në lidhje me përmbushjen e afateve ligjore deri në rikthimin tek burimi. Kjo për faktin se të gjithë rrugën, nga burimi (përpiluesi i kërkesës/ankesës/aplikimit) e përshkon koordinatori i informimit me përgjegjësinë për ta reflektuar atë në regjistrin elektronik.

- Koordinimin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe koordinimin e Informimit Publik në Bashkinë Fier e kryhen i njëjti person.

- Mënyra më e shpejtë dhe efikase e publikimit të infomacioneve por edhe i njoftimeve të ndryshme dhe të konsultimit (kryesisht për dëgjesat publike) mbetet ajo online (rrjetet sociale), pasi rezulton më i shpejtë dhe masivisht i përdorshëm edhe nga komuniteti. Nga ana tjetër Bashkia Fier vazhdon ta shikojë këtë si mënyrën më të shpejtë të shpërndarjes së njoftimin dhe informacionit.

- Problematike mbetet pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjesa publike. Edhe pse njoftimet bëhen në disa mënyra, prezenca qytetare vazhdon të ketë një kurbë konstante, fakt që tregon se nuk ka ndonjë progres të dukshëm në këtë aspekt. Kjo jo për faktin e mungesës së informacionit, por të indiferences së qytetarëve.

- Takimet e drejtëpërdrejta dhe komunikimi me Kryetarin, për qytetarët mbeten më të besueshme dhe të efektshme. Ata besojnë se shkaktarë për moszgjidhje të ankesave apo

problematikave të tyre të deleguara institucionalisht janë strukturat vartëse (punonjësit) dhe jo vullneti politik, apo pamundësia.

• Dëgjesat publike janë një praktikë që Bashkia Fier e realizon në mënyrë permanente gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm, sikurse dhe projekteve infratrukturore dhe ato me ndikim në komunitet.

## Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Bazuar në metodologjinë e ndjekur për këtë studim, një nga mënyrat e marrjes së mendimit mbi nivelin e transparencës dhe efikasitetit të procesit të konsultimit publik ishte edhe anketimi online. Anketa është klikuar nga 106 qytetarë të bashkisë Fier, 77 banorë të zonës urbane dhe 29 të zonës rurale, por vetëm 101 prej tyre e kanë plotësuar atë deri në fund.




*Figure 1 - Grafiku i ndarjes së anketuesve sipas zonave*

Pjesa më e madhe e anketuesve rezultojnë të jenë gra/vajza (femra) me një numër prej 65 anketave të plotësuar prej tyre duke nxjerrë në pah edhe rëndësisnë që kjo gjini I jep këtij procesi. 36 të tjerë janë burra/djem (meshkuj) dhe 5 kanë preferuar mos ta deklarojnë gjininë.




*Figure 2- Grafiku i ndarjes gjinore të të anketuarve*

Përsa i përket moshës, përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në anketim e ka grupmosha 30-45 vjeç me 45 pjesëmarrës, ku 29 prej tyre rezultojnë gra/vajza, më pas vjen grupmosha 46-65 vjeç me një numër prej 23 anketuesish, ku 21 janë gra/vajza, 23 anketues rezultojnë të grupmoshës 15-29 vjeç, prej të cilëve 15 gra/vajza. Grupmosha më e papërfaqësuer në këtë anketë online është mbi 65 vjeç, e cila nuk ka patur asnjë përfaqësim në këtë anketë, fakt që tregon mungesën e njohjes dhe mundësisë në akses të kësaj grupmoshe në procese nëpërmjet teknologjisë. Nëse do të aplikohet marrja e mendimit qytetar nëpërmjet teknologjisë, kjo grupmoshë do të mbetet e papërfaqësuar.




*Figure 3- Grafiku i ndarjes së grupmoshës sipas gjinisë*

## Njohuri mbi ligjin për konsultimin publik

52 anketues janë shprehur se kanë njohuri mbi ligjin për konsultimin publik, kurse 49 prej tyre nuk kanë asnjë njohuri mbi këtë ligj, duke krijuar një vakum informacioni dhe mospërfaqësimi në shumë procese të rëndësishme në qeverisjen vendore, por edhe në jetën aktive në zonat e tyre.

Zëri i kësaj bërthame qytetarësh që përfaqëson të gjithë ata që nuk e kanë këtë informacion është i destinuar të mospërfaqësohet denjësisht, ose të mos përfaqësohet fare.

Grupmosha më e interesuar dhe e informuar në këtë aspekt rezulton të jetë 30 -45 vjeç dhe me përqindje më të lartë të gjinisë femër. Grafiku i mëposhtëm tregon në mënyrë të detajuar të dhënat për cdo grupmoshë dhe gjini.




*Figure 4 – Grafiku i njohurisve mbi ligjin për konsultimin publik në bazë gjinie dhe grupmoshe*

## Pjesëmarrja në dëgjesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak në dy vitet e fundit

Grupmosha 30-45 vjeç (femra) ka një interes më të lartë për të marrë pjesë në konsultimet publike dhe dëgjesat e organizuara nga ekzekutivi, ose vendimmarrësit lokal edhe pse jo në mënyrë të dukshme. Vetëm 12 prej tyre janë shprehur se kanë qenë pjesëmarrëse në këto takime dhe 13 prej tyre janë shprehur negativisht. Kjo pasohet nga grupmosha 46-65 vjeç, ku 9 prej tyre kanë qenë pjesë e dëgjesave/konsultimeve publik, kurse 12 nuk kanë qenë. Interes më të ulët rezulton të ketë grupmosha 15-29 vjeç me vetëm 1 anketues që ka frekuentuar këto takime, kundrejt 7 të tjerëve që kanë qenë indiferent. Në mënyrë të detajuar dhe të shprehur në përqindje e shpreh tabela nr.5.




*Figure 5- Grafiku i pjesëmarrja në dëgjesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak në dy vitet e fundit.*

## Njoftimi për dëgjesat publike

Për mënyrën e njoftimit apo informimit mbi organizimin e dëgjesave publike për objektin, vendin, apo orën e përcaktuar shihet një pasivitet nga anketuesit për ta shprehur atë. Burrat/djemtë (meshkujt) nuk kanë i janë përgjigjur asnjërës prej alternativave të dhëna për mënyrën e njoftimit, kurse gratë/vajzat (femrat) vetëm 13 prej tyre kanë preferuar të përgjigjen.

**Mënyrat/rrugët e njoftimin të përfshira në pyetësor ishin:**

- Njoftime nga regjistri elektronik/faqe ëeb e bashkisë
- Posta elektronike
- Lajmërim i publik afishuar në ambjentet e bashkisë
- Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
- Mediat Sociale
- Lajmërime individuale
- Njoftim nga administratori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar




*Figure 6-Grafiku për mënyrën e infomimit mbi dëgjesat pubklike*

## Besimi në Përmirësimin e Vendimmarrjes përmes Procedurave të Konsultimit Publik

Në lidhje me besimin se zhvillimi i procesit të konsultimeve publike ndikon në përmirësimin e vendimmarrjes duket se më skeptikë është gjina mashkullore: 23 prej tyre janë shprehur se kanë bësim, 12 nuk kanë dhe 1 pa përgjigje, 45 anketuese kanë besim, 11 nuk kanë dhe 9 kanë preferuar të mos përgjigjes.




*Figure 7-Grafiku i besimit rreth ndikimit të procesit të konsultimeve në vendimmarrje*

**Informacioni i marrë nga bashkia Fier në lidhje me njoftimin, organizimin, pasqyrimin, informimin publik mbi proceset e konsultimit publik**

Në emër të rrjetit POP, qendra "Epoka e Re", në rrugë zyrtare shkresë-protokoll, arkivoi në bashkinë Fier një kërkesë për informacion. Në mënyrë të fragmentizuar, për çdo pyetje përgjigjen e kthyer renditet si më poshtë:

| Kërkesa për informacion | Pergjigjet e bashkisë Fier | Komente / Mjetet e verifikimit | Vlerësi mi |
|---|---|---|---|
| 1. Sa dëgjesa dhe konsultime publike janë kryer në bashkinë Fier gjatë periudhës shtator 2023 – maj 2024 | Gjatë periudhës shtator 2023-maj 2024 janë kryer 4 konsultime publike në Bashkinë Fier. 2 konsultime i përkasin vitit 2023, përkatësisht dokumenti "Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024" dhe "Për miratimin e Buxhetit të Bashiksë Fier për vitin 2024 dhe numri të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2024". Ndërsa deri në maj të viti 2024 konsultimet këtyre dokumenteve"Për miatimin ePlanit Vendor Social të Strehimit për vitin 2024-2028 të Bashkisë Fier" dhe "Për miratimin e Planit të përmirësimit të arsimit parashkollor 2024-2026" të Bashkisë Fier" | Ky informacion mbështett në publikimet e bëra nga BF në faqen zyrtare të saj në linkun e mëposhtëm (https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/d.-publike-tetor.pdf)<br><br>Dhe<br><br>https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Njoftim.-per-degjese-publike.pdf<br><br>Gjatë hulumtimit është vënë re se nuk kanë qenë vetëm 4 dëgjesa por 10 dhe për këtë publikimet në faqen zyrtare janë të opjeshme përvec kalendarit të takimeve. | I realizuar |
